


MBRO

TRASHËGIMINË TËNDE



Kjo fletëpalosje u prodhua me mbështetjen financiare të projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Fuqizimi i mbrojtjes nga diskriminimi në Shqipëri" (Instrumenti Horizontal III). Përmbajtja e saj është përgjegjësi e vetme e autorit(ëve). Pikëpamjet e shprehura në të nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të Bashkimit Evropian ose të Këshillit të Evropës.



A JENI
SHTETAS SHQIPËTAR
QË PRETENDON QË I PËRKET NJËRËS
PREJ KËTYRE **PAKICAVE KOMBËTARE:**

**GREKE, MAQEDONASE, ARUMUNE, ROME,
EGJIPTIANE, BOSHNAJKE, MALAZEZE, SERBE,
BULLGARE**

Atëherë keni mundësinë që nëpërmjet një
procedure të thjeshtë të vet-identifikoheni si
i/e tillë.

Si mund ta bësh këtë?



Shumë thjeshtë, plotësoni formularin me të dhënat tuaja personale. Formulari mund të gjendet në faqen **Pamja e dokumentit - Qendra e Botimeve Zyrtare**. Bëni kujdes të plotësoni çdo rubrikë të tij.



Është veçanërisht e rëndësishme të plotësohet me kujdes sidomos pjesa e fundit e formularit që ka të bëjë me karakteristikat dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale të pakicës që ju pretendoni se i përkisni. Këto karakteristika, përveç gjuhës së pakicës që i përkisni, mund të jenë një këngë, instrument apo zakon festimi, një ditë e veçantë festimi që i përket komunitetit tuaj apo një profesion që karakterizon pakicën tuaj kombëtare.

Për shembull: Tradita e punimit e thurjes së kashtës, punimi i hekurit, marrja me blegtori, valle tradicionale etj

Ku duhet dorëzuar formulari?

Pasi të plotësohet ky formular, duhet të dorëzohet:




Ministrinë e Punëve të Brendshme ose të dërgohet me postë në këtë Ministri në adresën 'Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Nd. 1, Tiranë 1001'.



Gjatë orarit 08:00 – 16:30 nga e hëna deri të enjten, dhe gjatë orarit 08:00–14:00 të premten

Nuk është i nevojshëm asnjë dokument tjetër përveç këtij formulari.



Afatet

Brenda **30 ditëve** Komisioni pranon kërkesën tuaj dhe ju regjistron në listën e pakicës kombëtare me të cilën identifikoheni. Në raste të veçanta Komisioni mund të bëjë verifikime të mëtijshme për të cilat do ju njoftojë. Në çdo rast nëse Komisioni nuk ju kthen përgjigje për **60 ditë** nga dita që ju ka njoftuar për verifikimet, kërkesa juaj për vetë deklaram do të konsiderohet e pranuar.

